NJOFTIM KONSULENCE - Ekspert analist

CESVI po zbaton projektin: ***"Shqipëri, Udhëto në Mënyrën Tënde: Menaxhim Multi-Aktor i Integruar i Turizmit Rural dhe Kulturor në Qarqet e Gjirokastrës dhe Beratit (TREC)"***, financuar nga Agjensia Italiane për Bashkëpunimin në Zhvillim (AICS)

Projekti kërkon kandidatë të kualifikuar për të mbështetur CESVI-in dhe Ekspertët italianë në realizimin e një vlerësimi të ndërmjetëm dhe final të ecurisë së projektit. Eksperti do të vizitojë zonat e përfshira në projektit duke shoqëruar ekspertët italianë, do të takohet me aktorët lokal e do të identifikojë aftësitë aktuale dhe ato të humbura, boshllëqet dhe burimet, si dhe do të japë rekomandimet e nevojshme si për CESVI dhe për Ekspertët Italianë të angazhuar në realizimin e këtij shërbimi.

Periudha e shërbimit: prill-korrik 2019

Vendi: Qarqet Berat e Gjirokastër, (bashkitë Berat, Skrapar, Përmet, Gjirokastër)

Kualifikimet e kërkuara

(i) Diplomë universitare në shkencat sociale ose shkenca te ngjashme. Studime të kryera në Itali dhe studime të mëtejshme në fushën e monitorimit dhe vleresimit përbëjnë avantazh;
(ii) Së paku pesë vjet eksperiencë dhe ekspertizë në fushën e vlerësimit dhe monitorimit të projekteve;
(iii) Aftësi prezantuese dhe komunikuese shumë të mira;
(iv) Aftësi të punoj në grup, në situata komplekse dhe nën presionin e kohës;
(v) Njohuri shumë të mira të gjuhës italiane dhe angleze;
(vi) Njohuri dhe kontakte me aktorët vendor përbëjnë avantazh.
(vii) Shtetësia shqiptare

Procesi i aplikimit

Të gjithë kandidatët e interesuar mund të aplikojnë me e-mail në adresën cesvi.albania@gmail.com duke çuar një letër interesi, metodologjinë e punës (maksimumi 1 faqe A4) dhe një CV në italisht. Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është **10 prill 2019.** Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen për intervistën me gojë.